



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI  
KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE**

Tiranë, më 31.10.2022

Dokument parlamentar

**R A P O R T**  
**PËR PROJEKTLIGJIN “BUXHETI I VITIT 2023”**  
*(shqyrtimi në parim)*

**Drejtuar:** Komisionit përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

• **HYRJE**

Bazuar në nenin 79 pika 2 dhe 80 të Rregullores së Kuvendit, në datë 27 tetor 2022, Komisioni për Sigurinë Kombëtare shqyrtoi në parim projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2023”, për institucionet që ky komision ka në fushën e tij të përgjegjësive si:

1. Ministrinë e Mbrojtjes;
2. Ministrinë e Brendshme;
3. Shërbimin Informativ Shtetëror;
4. Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve
5. Agjensinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile
6. Agjensinë e Mbikëqyrjes Policore

Në mbledhjet e komisionit morën pjesë Ministri i Brendshëm, Ministri i Mbrojtjes dhe përfaqësues të Ministrisë së Financave cilët bënë prezantimin në parim të projektbuxhetit për vitin 2023, arritjet e institucioneve të tyre, problematikat, menaxhimin e buxhetit të vitit 2022 dhe pritshmëritë e objektivat që do të arrihen me anë të projektbuxhetit 2023.

• **BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT**

Projektligji “Për buxhetin e vitit 2023” është propozuar nga Këshilli i Ministrave, mbështetur në:

- nenet 78, 83, pika 1, 158 dhe 159 të Kushtetutës;
- Nenin 30 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar.

Projektligji për buxhetin i nënshtrohet një procedure të posaçme shqyrtimi, e cila është e parashikuar në Rregulloren e Kuvendit, në nenet 78-85 të saj.

- **OBJEKTIVAT E BUXHETIT 2023**

Ritmi i rritjes ekonomike gjatë viteve të fundit, deri përpara goditjeve të tërmetit në nëntor 2019 dhe nga pandemia e Covid-19, ka treguar një trend pozitiv zhvillimi që është pasqyruar në një sërë parametrash makroekonomikë në vend. Performanca e vitit 2020 ka qenë, në aspektin ekonomik dhe të financave publike, një ndër vitet më të vështirë në tre dekada.

Ekonomia e vendit përjetoi dy goditje të forta brenda një harku kohor të shkurtër që përfshin tremujorin e katërt të vitit 2019 dhe vitin 2020, veçanërisht në tremujorin e dytë dhe të tretë të tij. Sidoqoftë, megjithë ndikimin e rëndë që të dy goditjet kanë pasur për ekonominë e vendit, në sajë të përgjigjeve relativisht të mira të politikave ekonomike dhe masave të duhura rregullatore të ndërmarra, të dhënat statistikore dëshmojnë se situata e përgjithshme në mbyllje të vitit 2020 ishte konsiderueshëm më pak e rëndë nga sa pritej në fillim të pandemisë, si dhe përgjatë vitit 2021 rimarrja e ritmit të ekonomisë ishte konsiderueshëm më e shpejtë sesa pritshmëritë fillestare.

Deri më tani, fundamentet kryesore ekonomike dhe financiare dhe stabiliteti i përgjithshëm makroekonomik i vendit ka rezistuar relativisht mjaft mirë ndaj këtyre goditjeve. Edhe përgjatë goditjes më të fundit të jashtme si pasojë e luftës në Ukrainë, duket se deri më tani ekonomia jonë është përshtatur dhe ka performuar relativisht mirë. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2022, ekonomia shqiptare shfaqti shenja inkurajuese duke treguar një stabilizim të aktivitetit ekonomik. Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) për gjashtëmujorin e parë të vitit 2022 ka shënuar rritje prej rreth 4.17 përqind krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2021 sipas vlerësimit më të fundit të disponueshëm nga INSTAT.

Në projektbuxhetin e vitit 2023, programimi i të ardhurave buxhetore mbështet synimet e Qeverisë për rritje ekonomike të qëndrueshme, si dhe uljen e vazhdueshme të defiçitit buxhetor dhe stokut të borxhit publik.

Ky programim bazohet në përmirësimin e administrimit fiskal dhe minimizimin e informalitetit në ekonomi, duke mbështetur në këtë mënyrë rritjen ekonomike, si dhe duke nxitur prodhimin dhe eksportet.

**Komisioni për Sigurinë Kombëtare**, gjatë shqyrtimit të këtij projektligji në parim, u fokusua më shumë në aspektet e buxhetit të cilat trajtojnë elementet financiare në rendin publik dhe sigurinë e vendit, ku analizoi me vëmendje buxhetin e parashikuar ndaj institucioneve të cilat janë përgjegjëse për çështjet e sigurisë dhe rendit publik apo dhe institucioneve që kontribuojnë në këto dy komponentë, si Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Shërbimi Informativ Shtetëror, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Agjensia e Mbikëqyrjes Policore dhe Agjensia Kombëtare e Mbrojtjes Civile.

**Projektbuxheti i vitit 2023 në mënyrë të përmbledhur për institucionet të cilat janë nën fushën e përgjegjësisë së Komisionit për Sigurinë Kombëtare, parashikon të arrijë:**

## MINISTRIA E BRENDSHME

**Buxheti, për vitin 2023, për Ministrinë e Brendshme parashikohet në vlerën 24,129,147 lekë miliard lekë ose me një rritje 14% në raport me planin e vitit 2022.**

### Prioritetet për vitin 2023:

- Mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe garantimin e sigurisë së jetës, shëndetit dhe pronës së qytetarit, të cilat janë dhe prioritetet për veprimtarinë e Policisë së Shtetit, e cila do të ketë si togfjalësh kyç në veprimtarinë e saj, 'kontrollin e territorit' dhe 'policimin në komunitet', të realizuara në praktikë përmes riorganizimit të sistemit të prezencës së policisë në territor, në funksion të një kontrolli më efektiv të tij dhe transformimin rrënjësor të marrëdhënieve dhe shërbimit ndaj komunitetit.
- Sigurimin e rendit publik, pronës publike e private, rritjen e parametrave të sigurisë rrugore, krijimin e një mjedisi të sigurt për komunitetin, nëpërmjet shërbimeve profesionale, në kohë dhe me cilësi dhe policimit me standartet me të larta të performancës.
- Të kontribuojë në përmirësimin e vazhdueshëm të Sigurisë së Personaliteteve Vendas dhe të Huaj, të Objekteve të Rëndësishme të Veçantë nëpërmjet rritjes së kapaciteteve menaxhuese dhe përputhjes me standartet europiane në fushën e sigurisë.
- Konsolidimin e mëtejshëm të një sistemi bashkëkohor të dixhitalizuar të regjistrit kombëtar të gjendjes civile (RKGJC), të sistemit të regjistrit kombëtar të adresave (RKA) dhe sistemit të personalizimit dhe shpërndarjes së letërnjoftimit elektronik dhe pasaportës biometrike

Ne mënyre të veçante ka një rritje të investimeve në teknologji ku në mënyrë të veçantë përmendim:

- Rritjen e investimeve në masën 56% për Policinë e Shtetit, ku pjesa më e madhe e kësaj rritje shkon për përmirësimin e infrastrukturës së teknologjisë dhe informacionit të Policisë së shtetit dhe rritjen e sigurisë së saj.
- Garantimin e financimit të disa projekteve në fushën e teknologjisë së informacionit, të filluara në v.2022 nga AKSHI, për llogaritë të Policisë së Shtetit, me fond rreth 278 milion lekë.
- Financimi i Projektit "JONIADA" i cili përshin blerjen e mjeteve lundruese për rritjen e sigurisë dhe kontrollit në zonat e plazhit gjatë sezonit turistik, me vlerë rreth 110 milion lekë.
- Rikonstruksioni i disa drejtorive dhe komisariateve të policisë (dr. Policisë Diber, dr. policisë Elbasan).

- Kemi rritje të financimit të Shpenzimeve të Personelit për të gjitha programet e Ministrisë duke e mbuluar 100% efektin financiar të ndryshimit të pagave për këto struktura, mbikohën e punës, largësinë për shërbimet jashtë vendbanimet etj,
- Është parashikuar mbulimi i efektit financiar të trajtimit me ushqim të punonjësve të Gardës së Republikës.
- Mbështetjen e Agjencisë e Mbikëqyrjes Policore me fonde investime për ne fushën e teknologjisë, blerjeve të pajisjeve dhe shtimin e agjenteve të punës.
- Rritja e investimeve për Shërbimin e Gjendjes Civile për Projektin “Përmirësimi i Regjistrimit Kombëtar të Adresave”.

- **MINISTRIA E MBROJTJES**

**Buxheti për vitin 2023 për Ministrinë së Mbrojtjes parashikohet në vlerën 40,256,139 lekë .**

Prioritetet për vitin 2023:

- Modernizimin e kapaciteteve dhe infrastrukturës së FA duke: 39 o zhvilluar kapacitetet e FA në përputhje me Planin Afatgjatë të Zhvillimit; o vijuar pajisjen e Forcave Tokësore me armatim të ri të ndërveprueshëm me aleatët në NATO; o zgjeruar investimet në infrastrukturë për përmirësimin e mjediseve të punës dhe ushtarake; o modernizuar pajisjet dhe sistemet kompjuterike.
- Vijimin e pjesëmarrjes në operacionet e NATO-s duke rritur nivelin e angazhimit të FA, në operacionet e Aleancës dhe pjesëmarrjen në misionet e iniciativat e reja që NATO mund të ndërmarrë.
- Zhvillimin dhe mbajtja në gatishmëri të kapaciteteve të FA për operacione të mbrojtjes kombëtare dhe kolektive, operacione në përgjigje të krizave, si dhe kapacitetet për përballimin e Emergjencave Civile, dhënien e ndihmës vendeve të rajonit në rast emergjencash civile në kuadrin e NATO-s, OKB-se dhe BE-së.
- Lartësimin e figurës dhe integritetit të ushtarakut, nëpërmjet zhvillimit të politikave të nevojshme në fushën e personelit, promovimit në karrierë, trajtimit të ushtarakut, rritjes së transparencës, llogaridhënies, si dhe eliminimit të korrupsionit në Forcat e Armatosura.

Buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes përbëhet nga shtatë programe Buxhetore:

1. Programi buxhetor “Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi”;
2. Programi buxhetor “Forcat e Luftimit”;
3. Programi buxhetor “Mbështetja e Luftimit”;
4. Programi buxhetor “Arsimimi Ushtarak”;
5. Programi buxhetor “Mbështetja Sociale për Ushtarakët”;
6. Programi buxhetor “Mbështetja Shëndetësore”;
7. Programi buxhetor “Emergjencat Civile”.

Programi buxhetor “Forcat e Luftimit” në përbërje të së cilit janë strukturat ushtarake Komanda e Forcave Tokësore, Detare e Ajrore, mund të konsiderohet si programi kryesor buxhetor dhe të cilit i alokuar pjesë më e madhe e burimeve gjatë të gjithë periudhës së Programit Buxhetor Afatmesëm dhe llogaritet ndërmjet 35 dhe 45% e buxhetit të Ministrisë së Mbrojtjes. Programet buxhetore që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me forcat e armatosura kanë parashikuar një rritje të konsiderueshme në disa zëra të shpenzimeve gjatë kësaj periudhë, në veçanti rritjen e pagave dhe shpenzimeve kapitale.

- **DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE**

Në funksion të përparësive kryesore të sistemit të drejtësisë, në projektligjin për buxhetin e vitit 2023, janë përcaktuar dhe objektivat për:

- reformimin e sistemit penitenciar në tërësi.
- menaxhimit efektiv të institucioneve të vuajtjes së dënimit dhe rritjes së profesionalizmit dhe integritetit të stafit të burgjeve, policor dhe civil.

Rezultatet që synohet të arrihen nëpërmjet këtij buxheti rezultojnë si vijon:

- Përmirësimi i kushteve në sistemin penitenciar dhe uljen e mbipopullimit në burgje.
- Rritjen e nivelit të sigurisë fizike në I EVP nëpërmjet vëzhgimit dhe kontrollit me sisteme sigurie, të monitorimit elektronik të të dënuarve dhe policisë së burgjeve.
- Rikonstrukcionin dhe përshtatjen e infrastrukturës ekzistuese sipas standardeve të ofrimit të shërbimeve të përshtatshme për kategorinë e të moshuarve në sistemin e burgjeve.

Nga shqyrtimi i projektligjit të buxhetit propozuar për vitin 2023 sa i përket sistemit të burgjeve referuar tavanëve të miratuara për shpenzimet korrente dhe kapitale:

Janë planifikuar në total **rreth 6.66 miliardë lekë**, prej të cilave:

- **6.44 miliard lekë** për shpenzimet korrente (paga, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative).
- **220 milionë lekë** për shpenzime kapitale

- **AGJENCIA E MBIKQYRJES POLICORE**

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, bazuar në kërkesat e bëra dhe prezantimi i Fishë – projekteve, në PBA-në për vitin 2023, i janë parashikuar fonde buxhetore, sipas tabelës:

Nr.	Artik.	Emërtimi i artikullit	Plani	Limiti
-----	--------	-----------------------	-------	--------

			Viti 2022	Viti 2023
1	600	Paga&shpenzime personeli	170,000	170,000
2	601	Sig.shoqërore&shëndetësore	28,000	28,000
3	602	Mallra dhe shërbime	40,000	40,000
4	606	Transferime për buxhetet familjare&individët	2,000	2,000
5	231	Shpenz.për rritjen e aktive të trupëzuara	13,115	49,850
TOTALI			253,115	289,850

### • EMERGJENCAT CIVILE

Risia e këtij buxheti në krahasim me atë të vitit 2022 është fakti se ka një rritje të ndjeshme të fondeve, qoftë ato për shpenzimeve korente edhe fondet për investime. Në mbështetje të këtij buxheti AKMC synon të realizojë një sere objektivash, konkretisht:

1. Sigurimi i logjistikës së nevojshme për mbështetjen e operacioneve humanitare në rastet e fatkeqësive natyrore, si dhe misionet ndërkombetare.
2. Sigurimi i një infrastrukture efikase, nëpërmjet investimeve për parandalimin e fatkeqësive nëpërmjet projekteve të Pushtetit vendor. Kjo do të siguroj edhe uljen e ndjeshme të fatkeqësive natyrore, uljen dhe minimizimin e jetëve të humbura të njerëzve, dëmtimin e pasurisë, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit.
3. Sigurimi i një informacioni të nevojshëm, bashkëkohor dhe modernë për të gjitha institucionet nëpërmjet shërbimit Satelitor.
4. Realizimi i likujdimit total për detyrimet e prapambetura të qytetarëve (për fatkeqësitë e ndodhura në banesat dhe pronën e tyre “Llog 604”).

### • SHËRBIMI INFORMATIV SHTETËROR

Në lidhje me SHISH, treguesi më i mirë i mbështetjes dhe vëmendjes së mazhorances ndaj këtij shërbimi të rëndësishëm për sigurinë kombëtare, mjafton ti referohemi treguesve buxhetorë ndër vite për këtë institucion.

Mbështetja buxhetore ndaj këtij shërbimi tregon qartë synimin e qeverisë për forcimin dhe modernizimin e këtij institucioni si nevojë për t’iu përgjigjur sfidave të rëndësishme të këtij shërbimi në çështjet e sigurisë kombëtare.

Për këtë vit, SHISH i është parashikuar nje fond në shpenzimet e përgjithshme në shumën 1.876.900 mijë lekë.

Ky fond krahasuar me kërkesat buxhetore të paraqitura nga ana e SHISH është 4% më pak se kërkesa.

- **PËRFUNDIME**

Komisioni për Sigurinë Kombëtare në përfundim të diskutimeve, me shumicë votash vendosi të miratojë në parim projektligjin ” Për buxhetin e vitit 2023” dhe dërgimin e këtij raporti Komisionit për Ekonominë dhe Financat.

**RELATOR**

Xhemal QEFALIA  
Antoneta DHIMA  
Bardhyl KOLLÇAKU  
Vullnet SINAJ  
Denis DELIU  
Luan DUZHA

**KRYETAR**

Nasip NAÇO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI  
KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE**

Tiranë, më 15.11.2022  
Dokument parlamentar

**R A P O R T**

**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2023”**  
*(shqyrtimi nen për nen)*

**Drejtuar :** Komisionit për Ekonominë dhe Financat.

Bazuar në nenin 79 pika 2 dhe 80 të Rregullores së Kuvendit, në datën 15 nëntor 2022, Komisioni për Sigurinë Kombëtare shqyrtoi nen për nen projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2023”.

Në mbledhjen e komisionit morën pjesë përfaqësues nga Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, zëvendësudrejtori i Shërbimit Informativ Shtetëror dhe përfaqësues nga Ministria e Financave.

➤ **BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT**

Projektligji “Për buxhetin e vitit 2020” është propozuar nga Këshilli i Ministrave, mbështetur në:

- nenet 78, 83, pika 1, 158 dhe 159 të Kushtetutës;
- Nenin 30 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar.

Projektligji për buxhetin i nënshtrohet një procedure të posaçme shqyrtimi, e cila është e parashikuar në Rregulloren e Kuvendit, në nenet 78-85 të saj.

➤ **OBJEKTIVAT E BUXHETIT 2023**

Ritmi i rritjes ekonomike gjatë viteve të fundit, deri përpara goditjeve të tërmetit në nëntor 2019 dhe nga pandemia e Covid-19, ka treguar një trend pozitiv zhvillimi që është pasqyruar në një sërë parametrash makroekonomikë në vend. Performanca e vitit 2020 ka qenë, në aspektin ekonomik dhe të financave publike, një ndër vitet më të vështirë në tre dekada.



Ekonomia e vendit përjetoi dy goditje të forta brenda një harku kohor të shkurtër që përfshin tremujorin e katërt të vitit 2019 dhe vitin 2020, veçanërisht në tremujorin e dytë dhe të tretë të tij. Sidoqoftë, megjithë ndikimin e rëndë që të dy goditjet kanë pasur për ekonominë e vendit, në sajë të përgjigjeve relativisht të mira të politikave ekonomike dhe masave të duhura rregullatore të ndërmarra, të dhënat statistikore dëshmojnë se situata e përgjithshme në mbyllje të vitit 2020 ishte konsiderueshëm më pak e rëndë nga sa pritej në fillim të pandemisë, si dhe përgjatë vitit 2021 rimarrja e ritmit të ekonomisë ishte konsiderueshëm më e shpejtë sesa pritshmëritë fillestare.

Deri më tani, fundamentet kryesore ekonomike dhe financiare dhe stabiliteti i përgjithshëm makroekonomik i vendit ka rezistuar relativisht mjaft mirë ndaj këtyre goditjeve. Edhe përgjatë goditjes më të fundit të jashtme si pasojë e luftës në Ukrainë, duket se deri më tani ekonomia jonë është përshtatur dhe ka performuar relativisht mirë. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2022, ekonomia shqiptare shfaqti shenja inkurajuese duke treguar një stabilizim të aktivitetit ekonomik. Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) për gjashtëmujorin e parë të vitit 2022 ka shënuar rritje prej rreth 4.17 përqind krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2021 sipas vlerësimit më të fundit të disponueshëm nga INSTAT.

Në projektbuxhetin e vitit 2023, programimi i të ardhurave buxhetore mbështet synimet e Qeverisë për rritje ekonomike të qëndrueshme, si dhe uljen e vazhdueshme të defiçitit buxhetor dhe stokut të borxhit publik.

Ky programim bazohet në përmirësimin e administrimit fiskal dhe minimizimin e informalitetit në ekonomi, duke mbështetur në këtë mënyrë rritjen ekonomike, si dhe duke nxitur prodhimin dhe eksportet.

**Komisioni për Sigurinë Kombëtare**, gjatë shqyrtimit të këtij projektligji, u fokusua më shumë në aspektet e buxhetit të cilat trajtojnë elementet financiare në rendin publik dhe sigurinë e vendit, ku analizoi me vëmendje buxhetin e parashikuar ndaj institucioneve të cilat janë përgjegjëse për çështjet e sigurisë dhe rendit publik apo dhe institucioneve që kontribuojnë në këto dy komponentë, si Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes dhe Shërbimi Informativ Shtetëror

**Projektbuxheti i vitit 2023 në mënyrë të përmbledhur për institucionet e thirrura dhe të cilat janë nën fushën e përgjegjësisë së Komisionit për Sigurinë Kombëtare, parashikon të arrijë:**

## **MINISTRIA E BRENDSHME**

**Buxheti, për vitin 2023, për Ministrinë e Brendshme parashikohet në vlerën 24,129,147 lekë miliard lekë ose me një rritje 14% në raport me planin e vitit 2022.**

Prioritetet për vitin 2023:

- Mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe garantimin e sigurisë së jetës, shëndetit dhe pronës së qytetarit, të cilat janë dhe prioritete për veprimtarinë e Policisë së Shtetit, e cila do të ketë si togfjalësh kyç në veprimtarinë e saj, ‘kontrollin e territorit’ dhe ‘policimin në komunitet’, të realizuara në praktikë përmes riorganizimit të sistemit të prezencës së policisë në territor, në funksion të një kontrolli më efektiv të tij dhe transformimin rrënjësor të marrëdhënieve dhe shërbimit ndaj komunitetit.
- Sigurimin e rendit publik, pronës publike e private, rritjen e parametrave të sigurisë rrugore, krijimin e një mjedisi të sigurt për komunitetin, nëpërmjet shërbimeve profesionale, në kohë dhe me cilësi dhe policimit me standardet me të larta të performancës.
- Të kontribuojë në përmirësimin e vazhdueshëm të Sigurisë së Personaliteteve Vendas dhe të Huaj, të Objekteve të Rëndësisë së Veçantë nëpërmjet rritjes së kapaciteteve menaxhuese dhe përputhjes me standartet europiane në fushën e sigurisë.
- Konsolidimin e mëtejshëm të një sistemi bashkëkohor të dixhitalizuar të regjistrit kombëtar të gjendjes civile (RKGJC), të sistemit të regjistrit kombëtar të adresave (RKA) dhe sistemit të personalizimit dhe shpërndarjes së letërnjoftimit elektronik dhe pasaportës biometrike

Sipas zërave kryesorë të shpenzimeve, buxheti i parashikuar për vitin 2023 paraqitet si më poshtë:

- **Për shpenzimet e personelit** (paga dhe sigurime shoqërore), taveni është **18.2 miliard lekë** ose me një **rritje 8%** në raport me buxhetin e vitit 2022.  
Në raport me buxhetin në total këto shpenzime zënë rreth 75%.
- **Për Shpenzimet të tjera** (mallra e shërbime dhe transferime), taveni është **4 miliard lekë** ose me një **rritje 34%** në raport me buxhetin e vitit 2022.  
Në raport me buxhetin në total këto shpenzime zënë rreth 17%.
- **Për Shpenzimet për investime** (Financim i Brendshëm), taveni është **1.43 miliard lekë** ose me një **rritje 43%** në raport me buxhetin e vitit 2022.  
Në raport me buxhetin në total këto shpenzime zënë rreth 6%.
- **Për Shpenzimet për investime** (Financim i Huaj), taveni është **460 milion lekë**, ose me një **rritje 31%** në raport me buxhetin e vitit 2022.  
Në raport me buxhetin në total këto shpenzime zënë rreth 2%.

**Në bazë të taveve të parashikuara në pr.ligjin e buxhetit rezulton se me këto tavane garantohet mbështetja dhe funksionimi normal i strukturave të Ministrisë së Brendshme, përmirësimin i trajtimit të punonjësve të strukturave me status të veçantë, rritja e investimeve në teknologji, krijimin e kushteve të punës dhe përmirësimi i shërbimeve të sigurisë.**

Ne mënyrë të veçantë si dhe kemi një rritje të investimeve në teknologji ku në mënyrë të veçantë përmendim:

- Rritjen e investimeve ne masën **56%** për Policinë e Shtetit, ku pjesa me e madhe e kësaj rritje shkon për përmirësimin e infrastrukturës se teknologjisë dhe informacionit te Policisë se shtetit dhe rritjen e sigurisë se saj.
- Garantimin e financimit te disa projekteve ne fushën e teknologjisë se informacionit, te filluara ne v.2022 nga AKSHI, për llogari te Policisë se Shtetit, me fond rreth 278 milion lekë.
- Financimi i Projektit "JONIADA" i cili përshin blerjen e mjeteve lundruese për rritjen e sigurisë dhe kontrollit ne zonat e plazhit gjate sezonit turistik, me vlere rreth 110 milion leke.
- Rikonstruksioni i disa drejtorive dhe komisariateve te polices( dr. Policisë Diber, dr. policisë Elbasan).
- Kemi rritje të financimit të Shpenzimeve të Personelit për të gjitha programet e Ministrisë duke e mbuluar 100% efektin financiar te ndryshimit te pagave për këto struktura, mbikohën e punës, largësinë për shërbimet jashtë vendbanimet etj,
- Është parashikuar mbulimi efektit financiar te trajtimit me ushqim te punonjësve te Gardës se Republikës.
- Mbështetjen e Agjencisë e Mbikëqyrjes Policore me fonde investime për ne fushën e teknologjisë, blerjeve te pajisjeve dhe shtimin e agjenteve te punës.
- Rritja e investimeve për Shërbimin e Gjendjes Civile për Projektin “Përmirësimi i Regjistrat Kombëtar te Adresave”.

## **MINISTRIA E MBROJTJES**

**Buxheti për vitin 2023 për Ministrinë së Mbrojtjes parashikohet në vlerën 40,256,139 lekë .**

### Prioritetet për vitin 2023:

- Modernizimin e kapaciteteve dhe infrastrukturës së FA duke: 39 o zhvilluar kapacitetet e FA në përputhje me Planin Afatgjatë të Zhvillimit; o vijuar pajisjen e Forcave Tokësore me armatim të ri të ndërveprueshëm me aleatët në NATO; o zgjeruar investimet në infrastrukturë për përmirësimin e mjediseve të punës dhe ushtarake; o modernizuar pajisjet dhe sistemet kompjuterike.
- Vijimin e pjesëmarrjes në operacionet e NATO-s duke rritur nivelin e angazhimit të FA, në operacionet e Aleancës dhe pjesëmarrjen në misionet e iniciativat e reja që NATO mund të ndërmarrë.
- Zhvillimin dhe mbajtja në gatishmëri të kapaciteteve të FA për operacione të mbrojtjes kombëtare dhe kolektive, operacione në përgjigje të krizave, si dhe kapacitetet për përballimin e Emergjencave Civile, dhënien e ndihmës vendeve të rajonit në rast emergjencash civile në kuadrin e NATO-s, OKB-se dhe BE-së.
- Lartësimin e figurës dhe integritetit të ushtarakut, nëpërmjet zhvillimit të politikave të nevojshme në fushën e personelit, promovimit në karrierë, trajtimit të ushtarakut, rritjes së transparencës, llogaridhënies, si dhe eliminimin e korrupsionit në Forcat e Armatosura.

### **Shpenzime korente:**

- Shpenzimet e personelit (600-601): 8,831 milion lekë ose 21.9% e totalit të buxhetit të MM për vitin 2023;
- Shpenzimet e tjera korrente (602-606): 13,738 milion lekë ose 34.1% e totalit të buxhetit të MM për vitin 2023;

### **Shpenzime kapitale:**

- Shpenzime kapitale të brendshme: 11,687 milion lekë ose 29% e totalit të buxhetit të MM për vitin 2023;
- Shpenzime kapitale me financim të huaj: 6.000 milion lekë ose 14.9% e totalit të buxhetit të MM për vitin 2023.

### **Totali i shpenzimeve kapitale: 17,687 milion lekë ose 43.9 % e totalit të buxhetit të MM për vitin 2023.**

Në përmbushje të angazhimeve të vendeve në Samitet e NATO-s në Uells e Varshavë, dhe objektivave të dokumenteve strategjike, nevojitet që në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Këshillin e Ministrave të vijojë puna për mbajtjen e nivelit të buxhetit të mbrojtjes mbi kufirin 2% të PBB, dhe që 20% e totali të shpenzimeve të shpenzohet në investime, në pajisje kritike dhe modernizim

- o Modernizimi me armatim të lehtë dhe municione për Forcat e Armatosura.

Buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes përbëhet nga shtatë programe Buxhetore:

8. Programi buxhetor “Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi”;
9. Programi buxhetor “Forcat e Luftimit”;
10. Programi buxhetor “Mbështetja e Luftimit”;
11. Programi buxhetor “Arsimimi Ushtarak”;
12. Programi buxhetor “Mbështetja Sociale për Ushtarakët”;
13. Programi buxhetor “Mbështetja Shëndetësore”;
14. Programi buxhetor “Emergjencat Civile”.

Programi buxhetor “Forcat e Luftimit” në përbërje të së cilit janë strukturat ushtarake Komanda e Forcave Tokësore, Detare e Ajrore, mund të konsiderohet si programi kryesor buxhetor dhe të cilit i alokuar pjesë më e madhe e burimeve gjatë të gjithë periudhës së Programit Buxhetor Afatmesëm dhe llogaritet ndërmjet 35 dhe 45% e buxhetit të Ministrisë së Mbrojtjes. Programet buxhetore që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me forcat e armatosura kanë parashikuar një rritje të konsiderueshme në disa zëra të shpenzimeve gjatë kësaj periudhë, në veçanti rritjen e pagave dhe shpenzimeve kapitale.

### **DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE**

Në funksion të përparësive kryesore të sistemit të drejtësisë, në projektligjin për buxhetin e vitit 2023, janë përcaktuar dhe objektivat për:

- reformimin e sistemit penitenciar në tërësi.
- menaxhimit efektiv të institucioneve të vuajtjes së dënimit dhe rritjes së profesionalizmit dhe integritetit të stafit të burgjeve, policor dhe civil.

Rezultatet që synohet të arrihen nëpërmjet këtij buxheti rezultojnë si vijon:

- Përmirësimi i kushteve në sistemin penitenciar dhe uljen e mbipopullimit në burgje.
- Rritjen e nivelit të sigurisë fizike në IEVP nëpërmjet vëzhgimit dhe kontrollit me sisteme sigurie, të monitorimit elektronik të të dënuarve dhe policisë së burgjeve.
- Rikonstrukcionin dhe përshtatjen e infrastrukturës ekzistuese sipas standardeve të ofrimit të shërbimeve të përshtatshme për kategorinë e të moshuarve në sistemin e burgjeve.

*Nga shqyrtimi i projektligjit të buxhetit propozuar për vitin 2023 sa i përket sistemit të burgjeve referuar tavanëve të miratuara për shpenzimet korrente dhe kapitale:*

- *janë planifikuar në total rreth 6.66 miliardë lekë, prej të cilave:*
  - *6.44 miliard lekë për shpenzimet korrente (paga, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative).*
  - *220 milionë lekë për shpenzime kapitale*

## **AGJENCIA E MBIKQYRJES POLICORE**

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, bazuar në kërkesat e bëra dhe prezantimi i Fishë – projekteve, në PBA-në për vitin 2023, i janë parashikuar fonde buxhetore, sipas tabelës:

Nr.	Artik.	Emërtimi i artikullit	Plani Viti 2022	Limiti
				Viti 2023
1	600	Paga&shpenzime personeli	170,000	170,000
2	601	Sig.shoqërore&shëndetësore	28,000	28,000
3	602	Mallra dhe shërbime	40,000	40,000
4	606	Transferime për buxhetet familjare&individët	2,000	2,000
5	231	Shpenz.për rritjen e aktive të trupëzuara	13,115	49,850
TOTALI			253,115	289,850

## **EMERGJENCAT CIVILE**

Risia e këtij buxheti në krahasim me atë të vitit 2022 është fakti se ka një rritje të ndjeshme të fondeve, qoftë ato për shpenzimeve korente edhe fondet për investime. Në mbështetje të këtij buxheti AKMC synon të realizojë një sere objektivash, konkretisht:

5. Sigurimi i logjistikës së nevojshme për mbështetjen e operacioneve humanitare në rastet e fatkeqësive natyrore, si dhe misionet ndërkombetare.
6. Sigurimi i një infrastrukture efikase, nëpërmjet investimeve për parandalimin e fatkeqësive nëpërmjet projekteve të Pushtetit vendor. Kjo do të siguroj edhe uljen e ndjeshme të fatkeqësive natyrore, uljen dhe minimizimin e jetëve të humbura të njerëzve, dëmtimin e pasurisë, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit.
7. Sigurimi i një informacioni të nevojshëm, bashkëkohor dhe modernë për të gjitha institucionet nëpërmjet shërbimit Satelitor.
8. Realizimi i likuidimit total për detyrimet e prapambetura të qytetarëve (për fatkeqësitë e ndodhura në banesat dhe pronën e tyre “Llog 604”).

Emergjencat civile si program buxhetor përbëhet nga Agjencia Kombetare e Mbrojtjes Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të shtetit .

Në programin financiar të vitit 2023, shifrat e miratuara për Emergjencat Civile paraqiten si më poshtë vijon:

- Totali i shpenzimeve buxhetore është **4.5 Miliardë Lekë**

Nga të cilat:

**-1,3 Miliardë** lekë janë shpenzimet korente

**-3,2 Miliardë** lekë janë shpenzimet kapitale.

- Sa i përket shpenzimeve korente:

**-1.1 Miliardë Lekë** janë shpenzimet e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile

**-155 Milionë Lekë** janë shpenzimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit

- Sa i përket Shpenzime kapitale

**-1,35 Miliardë lekë** janë Financime të Brendshme

**-1,9 Miliardë lekë** janë Financime të Huaja

Në shumën prej **1,35 Miliardë lekë** financime të brendshme:

-AKMC ka **1,3 Miliardë lekë**

-Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit ka afërsisht **50 Milionë lekë**.

Financimet e Huaja në vlerën **1,9 Miliardë lekë** janë totalisht për AKMC.

Fondi për **Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore** është një mekanizëm financiar që mbështet politikën kombëtare të parandalimit dhe menaxhimit rajonal dhe vendor të fatkeqësive natyrore e të tjera.

Për vitin 2023, Fondi për **Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore** përbëhet nga fondi i akorduar në buxhetin e vitit 2023 në programin “Emergjencat Civile”, në Ministrinë e Mbrojtjes

## **SHËRBIMI INFORMATIV SHTETËROR**

Në lidhje me SHISH, treguesi më i mirë i mbështetjes dhe vëmendjes së mazhorances ndaj këtij shërbimi të rëndësishëm për sigurinë kombëtare, mjafton ti referohemi treguesve buxhetorë ndër vite për këtë institucion.

Mbështetja buxhetore ndaj këtij shërbimi tregon qartë synimin e qeverisë për forcimin dhe modernizimin e këtij institucioni si nevojë për t’iu përgjigjur sfidave të rëndësishme të këtij shërbimi në çështjet e sigurisë kombëtare.

Për këtë vit , SHISH i është parashikuar nje fond në shpenzimet e përgjithshme në shumën 1.876.900 mijë lekë.

Ky fond krahasuar me kërkesat buxhetore të paraqitura nga ana e SHISH është 4% më pak se kërkesa.

## **SUGJERIME PËR KOMISIONIN PËRGJEGJËS**

Komisioni për Sigurinë Kombëtare vendosi t’i kërkojë Komisionit të Ekonomisë:

- **Rishikim të tavaneve buxhetore për Ministrinë e Mbrojtjes, në nivel programi buxhetor për artikullin 231, “Shpenzime Kapitale”, brenda tavanit të miratuar për të.**

Kërkesa mbështetet në dokumentet strategjike të raportuara në NATO, kontratat e lidhura gjatë këtij viti, si dhe planit të shpenzimeve për vitin 2023, dhe ka për qëllim shtimin e fondeve për “Shpenzimet Kapitale” në vlerën 230,000 mijë lekë në programet :

- |   |                    |
|---|--------------------|
| 1.”Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi” | 80,000 mijë lekë;  |
| 2.”Arsimi Ushtarak”                         | 150,000 mijë lekë; |

Këto ndryshime kërkohen respektivisht për vijimin e projekteve të ngritjes së “Qendrës së Inovacionit në Siguri dhe Mbrojtje” dhe “Kampusit të Akademisë së Forcave të Armatosura” sipas planifikimit të zbatimit të tyre.

Pakësimi i fondeve në po të njëjtën vlerë do të bëhet nga programi buxhetor :

- |                                 |                    |
|---------------------------------|--------------------|
| 1.”Mbështetje për Shëndetësinë” | 230,000 mijë lekë. |
|---------------------------------|--------------------|

- **Të ketë në konsideratë shtimin e fondeve për Agjencinë e Mbikqyrjes Policore për vitin 2023, në shumën prej 209,029 mijë lekë, detajuar në artikujt si më poshtë:**

-“Paga, shpërblime dhe shpenzime të tjera personeli” në shumën prej 57,488 mijë lekë.  
-“Shpenzime për sigurime shoqërore e shendetësore” në shumën prej 9,904 mijë lekë.  
-“Mallra dhe shërbime të tjera”, në shumën prej 23,672 mijë lekë  
-“Transferta për buxhetet familjare dhe individë”, në shumën prej 2,500 mijë lekë.  
-“Shpenzime për rritjen e aktiveve të trupëzuara”, në shumën prej 89,65 mije lekë.

- **Përsa i përket Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, është e domosdoshme :**

-Garantimi i financimit të uniformave të reja për policinë e burgjeve.  
-Celjen e plotë të fondit prej 360 milion lekë, për fillimin e procedurave të prokurimit, për fillimin e ndërtimit të” Institutit për fëmijët në konflikt me ligjin”.  
-Mbështetjen buxhetore për miratimin e projekteve për rikonstruksionin e IEVP-ve Peqin, Drenovë dhe Fushë-Krujë.

Mungesa e fondeve buxhetore për projektet e kërkuara, përben faktor pengues në arritjen e qëllimit dhe misionit të DPB duke impaktuar në realizimin e indikatorve që janë përcaktuar në programin e burgjeve dhe në strategjinë sektoriale të drejtësisë.

- **Gjithashtu përsa i përket SHISH në funksion të mbajtjes së angazhimeve për plotësimin me sukses të objektivave për vitin 2023 ku mjedisi i sigurise është në ndryshim të vazhdueshëm paraqitet me një plan shpenzimesh 1.956.000 mijë lekë, ose 79 100 mijë lek më shumë se tavani i miratuar.**

- **PËRFUNDIME**

Komisioni për Sigurinë Kombëtare në përfundim të diskutimeve, me shumicë votash vendosi të miratojë miratojë nen për nen dhe në tërësi projektligjin ” Për buxhetin e vitit 2023” dhe dërgimin e këtij raporti Komisionit për Ekonominë dhe Financat dhe seancës plenare.

#### **RELATOR**

Antoneta DHIMA  
Xhemal QEFALIA  
Vullnet SINAJ  
Bardhyl KOLLÇAKU  
Denis DELIU  
Luan DUZHA

#### **KRYETAR**

Nasip NAÇO